



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë së aktit të komunës si në vijim:

Vendimin 01Nr.104/02-18194/2026 për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në ZK Elezaj
I miratuar më datë: 30.07.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.08.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2026, ka miratuar Vendimin 01Nr.104/02-18194/2026 për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në ZK Elezaj.

MAPL, konstaton së akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, është bazuar në nenin 12 paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, shkronjat (b), (c), (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008 të publikuar me 04.06.2008), si dhe nenet 24 dhe 25 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenin 29 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në nenin 6 pika 2 shkronja (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 30.07.2026, dhe është miratuar me 11 vota për, 2 kundër dhe 7 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Sabedin Vishi, gradonačelnik opštine Kačanik Selajdin Troni, predsedavajući Skupštine opštine Kačanik
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,
Od:	Erbilin Hetemi, rukovodilac Pravnog odeljenja/MALS
Odgovorni službenici:	
1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika
2.Službenik za izradu pravne procene	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kačanik
Vrsta odluke:	Odluka

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članom 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i Uredbe (VRK) br. 03/2026 o postupku administrativnog razmatranja opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je prihvatilo na obavezno razmatranje zakonitosti sledeći opštinski akt:

Odluku 01br.104/02-18194/2026 o objavljivanju od opšteg javnog interesa katastarskih parcela u K.Z. Elezaj
Usvojena dana, 30.07.2026.
Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 06.08.2026.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

OBRAZLOŽENJE

Skupština opštine Kačanik, na sednici održanoj dana, 30.07.2026. godine, usvojila je Odluku 01br.104/02-18194/2026 o objavljivanju od opšteg javnog interesa katastarskih parcela u K.Z. Elezaj.

MALS, konstatuje da je akt koji je izdala Skupština opštine Kačanik zasnovan na članu 12. stav 2. tačka (d), u vezi sa članom 17. tačke (b), (c), (f) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi Republike Kosova (Službeni glasnik Republike Kosova br. 28/2008 objavljen dana, 04.06.2008. godine), kao i na članovima 24. i 25. Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 29. stav 5. Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, članu 6. tačka 2. tačke (h) i (k) Statuta opštine Kačanik od dana, 25.09.2008. godine i izmenama i dopunama Statuta opštine Kačanik. 01.br.60/01-12895/2020 od dana, 30.06.2020.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Kačanik održanoj 30.07.2026. godine sa 11 glasova "za", 2 "protiv" i 7 "uzdržanih".

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.